



Prishtinë, 18 maj 2026
Kodi i ZRRE-së: V_3240_2026

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Mbështetur në Nenin 9, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, Nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5, Nenin 25, Nenin 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084); Dispozitat e Nenit 28, Paragrafi 1.26 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085); Dispozitat e Nenit 10 të Ligjit për Energjinë (Ligji Nr. 05/L-081); Dispozitat e Nenit 10 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, dhe Kërkesën e OSSH-së të datës 15.07.2025 për shqyrtim dhe aprovim të Planit Dhjetë (10) Vjeçar për Zhvillimin e Rrjetit të Shpërndarjes për periudhën 2026 – 2035,

në seancën e mbajtur me datë 18 maj 2026 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** - Planit Dhjetë (10) Vjeçar për Zhvillimin e Rrjetit të Shpërndarjes për periudhën 2026 – 2035 për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH).
- II. **OBLIGOHET** – Operatori i Sistemit të Shpërndarjes KEDS SH.A, që të zbatojë projektet e planifikuara sipas këtij plani për funksionimin më të sigurt të Sistemit të Shpërndarjes.

A r s y e t i m

- Zyra e Rregullatorit për Energji (në tekstin e mëtejme: ZRRE) me datë 15.07.2025 ka pranuar kërkesën e OSSH-së për shqyrtim dhe aprovim të Planit Dhjetë (10) Vjeçar për Zhvillimin e Rrjetit të Shpërndarjes për periudhën 2026 – 2035”.
- ZRRE ka analizuar dokumentin dhe ka bërë vlerësimin e projekteve që duhet të përshihen në Planin Dhjetë (10) Vjeçar për Zhvillimin e Rrjetit të Shpërndarjes 2026 – 2035.
- ZRRE gjatë vlerësimit ka aplikuar një renditje prioritare të projekteve sipas rregullave në fuqi dhe programeve të bazuar në faktorët e prioritizimit të dakorduar ndërmjet OSSH dhe ZRRE.
- ZRRE pas vlerësimit të Planit Dhjetë (10) Vjeçar për Zhvillimin e Rrjetit të Shpërndarjes 2026 – 2035, të njëjtin e ka hapur për diskutim publik për të pranuar komente, sugjerime dhe vlerësime si nga të licencuarat po ashta edhe nga palët e interesit.



- ZRRE gjatë periudhës së vlerësimit ka mbajtur takime të përbashkëta konsultative me OSSH-në, ku janë sqaruar apo janë marrë përgjigjet në lidhje me çështjet e ngritura për projektet e propozuara nga OSSH.
- Pas përfundimit të konsultimit publik, dhe pas takimeve të shumta mes ZRRE dhe OSSH (KEDS) dhe pas përfshirjes së komenteve të ZRRE-së, OSSH ka dërguar dokumentin final për miratim në ZRRE.
- Bordi i ZRRE, pas vlerësimit dhe analizimit të Planit Dhjetë (10) Vjeçar për Zhvillimin e Rrjetit të Shpërndarjes 2026 – 2035 ka konstatuar që janë përmbushur kërkesat ligjore, dhe ka vlerësuar se projektet e përfshira në dokument janë të arsyeshme, të nevojshme dhe në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullative për zhvillimin afatgjatë të sistemit të shpërndarjes, prandaj ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.


IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.


Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.


Shtojcë: **Plani Dhjetë (10) Vjeçar për Zhvillimin e Rrjetit të Shpërndarjes për periudhën 2026 – 2035.**


Bordi i ZRRE-së:


Ymer Fejzullahu, Kryesues


Lutfije Dervishi, Anëtar


Gani Bucaj, Anëtar


Arta Isufi, Anëtar


Adnan Preniqi, Anëtar

Vendimi dhe dokumenti i dërgohet:

- Të licencuarit – KEDS SH.A, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.